



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:137277

Datë: 30.08.2022

Numri i dokumentit: 03371655

C.nr. 978/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil me gjyqtaren Afijete Sada Gllogjani dhe bashkëpunëtoren profesionale Gresa Sadiku, në çështjen juridike të paditëses Z.K.C. nga Gjakova, përfaqësuar nga Visar Prelaska avokat nga Gjakova, Rr."Sadik Stavileci" nr.4/A, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës, Drejtoria Komunale Arsimit, kontest pune - kompensim nga marrëdhënia e punës, vlera kontestit 1,660.50 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 04 gusht 2022, në prezencën e të autorizuarit të paditësit dhe në mungesë të paditurës, me datë 30 gusht 2022, murr këtë:

A K T G J Y K I M

DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës- Drejtoria Komunale e Arsimit që paditëses Z.K.C. nga Gjakova, në emër të diferencës së shtesës së kualifikimit në paga mujore, që nga data 01 korrik 2018 deri me 31 dhjetor 2020 për gjithsejtë 30 muaj të ia kompensoi shumën prej 1,660.50 (njëmijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë euro e pesëdhjetë cent) pra 27% të pagës bazë në lartësi prej 55.35 euro për 30 muaj duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8% në nivel vjetor e cila rrjedh nga data 04 gusht 2022 e deri në pagesën definitive, si dhe të ia kompensoi shpenzimet procedurale në shumë të tërësishme prej 326.60 (treqind e njëzet e gjashtë euro e gjashtëdhjetë), e që krejt këto të ia paguaj në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Paditësja me padi, parashtrësë dhe gjatë shqyrtimit nëpërmjet të autorizuarit të saj ka parashtruar se është e punësuar pranë të paditurës dhe atë në SHFMU "Pjetër Bogdani" në fshatin Damjan, Komuna e Gjakovës. Po ashtu paditësja është anëtare e sindikatës SBASHK dhe e njëjta paguan anëtarësi mujore 0.5%. Paditësja punon si mësimdhënëses e gjuhës angleze në atë Shkollë.. Paditësja është e diplomuar në Universitetin e Prishtinës Fakulteti i Edukimit – Qendra Prizren dhe ka marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, e njëjta është e licencuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Duke shikuar Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18 prill 2017, përkatësisht nenin 7 të kësaj Kontrate ku thuhet se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë për fakultet 3 dhe 4 vjeçar përfiton shtesë në vlerë të 27%. Duke shikuar listën e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, e paditura ka pranuar legjitimitetin mbi detyrimin e përcaktuar në këtë kontrate por pjesërisht i përgjigjet të njëjtës pasi që paditësja sipas kontratës së punës dhe listës së pagave e njëjta pagën bazë e ka në vlerë prej 421.00 euro dhe për kualifikim e njëjta realizon shtesën prej 58.32 euro, vlerë kjo e cila nuk përkon me vlerën e përcaktuar prej 27% mbi pagën bazë në bazë të kualifikimit andaj e njëjta kërkon diferencën e pjesës së mbetur. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë

të datës 18 prill 2017, gjegjësisht neni 7 paragrafi 1.3 është cekur në mënyrë specifike se me licencim fitohet e drejta në punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi për punëtorët dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë për: “mësimdhënësit me diplome fakulteti 3 dhe 4 vjeçar 27% e pagës bazë”.

I autorizuari paditëses gjatë shqyrtimit dhe fjalës përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë parashtrësës se datës 25 korrik 2022, sa i përket përgjigjes në padi konsideron se është irelevante për çështjen pasi që me Kontratën Kolektive të vitit 2017, janë paraparë në mënyrë të qartë kompensimi i diferencës mbi pagën bazë meqenëse e paditura pjesërisht e ka pranuar këtë kompensim dhe si rezultat i kësaj paditësjë kërkon diferencën e pjesës së mbetur. Sa i përket parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë gjatë shqyrtimit gjyqësor në seancë ka bërë zvogëlimin e kërkesëpadisë ashtu që e paditura të i detyrohet paditëses të i kompensoi diferencën në pagën bazë nga data 01 korrik 2018 e deri me 31 dhjetor 2020 meqenëse në këtë periudhë kohore nuk ka parashkrim ashtu siç është thirrur e paditura në përgjigje në padi. Kjo periudhë i bie që të jetë gjithsejtë 30 muaj dhe meqenëse e paditura paditëses i ka kompensuar në emër të kualifikimit shumë prej 58.32 euro por kjo shumë nuk e mbulon kompensimin siç është përcaktuar me kontratën kolektive 27% mbi pagën bazë. Bazuar në listën e pagave paga bazë të paditëses i bie të jetë 421.00 euro ashtu që 27% e pagës bazë i bie të jetë 113.67 euro. Meqenëse e paditura e ka paguar shumë prej 58.32 euro nga kjo shumë ka mbetur pa u paguar edhe 55.35 euro. Kjo shumë kur shumëzohet me 30 muaj i bie të jetë shuma e përgjithshme prej 1,660.50 euro, ashtu që ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 1,660.50 euro për periudhën kohore prej 01 korrik 2018 e deri me 31 dhjetor 2020, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë mbetet e njëjtë si në parashtrësën e datës 25 korrik 2022.

Shpenzimet procedurale i kërkoi sipas TA, për taksë gjyqësore, përpilim të padisë dhe përfaqësim në seancë.

I autorizuari i të paditurës jashtë afatit ligjor me datë 02 gusht 2022 i ka parashtruar Gjykatës përgjigjen në padi në të cilën ka parashtruar se Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë nënshkruar mes MASH dhe SBASHK nr.01B/2056 e datës 18 prill 2017, ashtu që në nenin 7 citim “Me licencim fitohet e drejta në punë avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi dhe mbi bazën e licencës së fituar, bazuar në UA nr.5/2017, sistemi i licencimit dhe i zhvillimit të mësimdhënësve në karrierë, u mundëson mësimdhënësve realizimin e stimulimit në të ardhura personale si vijon: “Mësimdhënës me licencë të karrierës 10% e pagës bazë, mësimdhënës me licence të avancuar 10% e pagës bazë, mësimdhënës me licence mentor 15% e pagës bazë”, por lidhur me këtë tek dispozita kalimtare të paraparë me nenin 45 paragrafi 1 citim “MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për ti ndihmuar dhe informuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtorive dhe shtëpive të studenteve që të bëjnë planifikim me kohë të buxhetit dhe kostos financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35 paragrafët 5,7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në Buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023” andaj edhe sipas Qarkores Buxhetore 2022/01 të datës 14 maj 2021 të lëshuar nga ana e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve tek granti specifik për Arsimin Parauniversitar nuk është paraparë pagesa e udhëtimit të mësimdhënësve dhe kompensimin e ushqimit në punë, si dhe thirren në parashkrim të kërkesës ku sipas nenit 87 të Ligjit nr.03/L-212 Ligjit të Punës citon “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Andaj bazuar nga sa u tha me sipër dhe të gjitha provave të bashkangjitura padisë nga paditësjë dhe përgjigjes në padi nga e paditura, si dhe duke u mbështetur në dispozitat e aplikueshme ligjore, gjykatës i propozon që kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar.

Shqyrtimin kryesor të treguar më datë 04 gusht 2022, Gjykata e ka mbajtur në mungesë të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt me propozimin e të autorizuarit të paditëses, sipas nenit 423.4 të LPK-së.

Për të vendosur në këtë çështje juridike Gjykata bëri nxjerrjen e provave: kontrata e punës me numër të protokollit 736/02 e datës 01 shtator 2015 (fotokopje), Diploma e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë me numër 96 e datës 17 maj 2013 - drejtimi Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, numri i Leg nr.2090/2021 e datës 15 qershor 2021, Licenca e mësimdhënësit me numër 100009695 e datës 26 dhjetor 2017, lista e pagave për muajin qershor 2018, qershor 2019 dhe qershor 2020 ku pas vlerësimit veç e veç të këtyre provave dhe në lidhshmërinë e tyre reciproke gjeti se kërkesëpadia e precizuar e paditësit është e bazuar dhe u aprovua.

Nga kontrata e punës e datës 01 shtator 2015 vërtetohet se paditësja në cilësinë e mësimdhënëses së gjuhës angleze në shkollën “Pjetër Bogdani” fshati Damjan me kualifikimin mësimdhënëse e Gjuhës Angleze ka lidhur kontratë të përhershme të punës. Paditësja posedon Diplomë nga Fakulteti i Edukimit Qendra në Prizren – Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë me numër të protokollit 96 e datës 17 maj 2013 dhe ka marrë titullin arsimtar i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze. Paditësja posedon licencën e mësimdhënësimit me numër 100009695 e lëshuar me datë 26 dhjetor 2012 deri me datë 26 dhjetor 2017, me të cilën vërtetohet se paditësja është licencuar për periudhe pesë vjeçare. Nga lista e pagave e muajit qershor 2018, vërtetohet se paditësja është në cilësi të mësimdhënëses në shkollën fillore me kualifikimin mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, realizon pagën bruto në shumë prej 544.32 euro, për kualifikim me fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 27.22 euro, tatimi në të ardhura 29.51 euro, ka tridhjetë e dy vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.44 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 485.15 euro. Nga lista e pagave e muajit qershor 2019 vërtetohet se paditësja është në cilësi të mësimdhënëses me kualifikimin mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, realizon pagën bruto në shumë prej 549.02 euro, për kualifikim me fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 27.45 euro, tatimi në të ardhura 29.96 euro, ka tridhjetë e katër vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.46 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 489.15 euro. Nga lista e pagave e muajit qershor 2020 vërtetohet se paditësja është në cilësi të mësimdhënëses në shkollën e lartshënuar f me kualifikimin mësimdhënëse e Gjuhës Angleze, realizon pagën bruto në shumë prej 551.12 euro, për kualifikim me fakultet realizon shtesën 58.32 euro, paguan për pensionim 27.56 euro, tatimi në të ardhura 30.16 euro, ka tridhjetë e pesë vite përvojë pune, është anëtare e SBASHK paguan anëtarësi (0.5%) në shumë prej 2.47 euro, pagën neto e ka me gradën “A”-421 dhe realizon pagën neto 490.93 euro.

Lidhur me kompensimin gjegjësisht diferencën e kompensimit në paga mujore që ka realizuar paditësja Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 7 pika 1.3 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18 prill 2017 sipas të cilës dispozitë përcaktohet se: ”Me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë pika 1.3 mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% të pagës bazë andaj bazuar dhe në provat e lartcekura përkatësisht në diplomën numër 96 e datës 13 maj 2013 me të cilin paditësja ka fituar titullin arsimtare e Gjuhës Angleze. Aktvendimi mbi licencën numër 100009695 me të cilën vërtetohet rrethana se paditësja posedon licencën e mësimdhënëses së vlefshme nga data 26 dhjetor 2012 deri me 26 dhjetor 2017, mirëpo sipas Udhëzimit administrativ nr. 5/2017 sistemi i licencimit dhe zhvillimit të mësimdhënëses në karrierë neni 33 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 “Vazhdohe për pesë vite

licencat e karrierës për mësimdhënësit e licencuar në vitet 2012, 2013 dhe 2014 licencat e lëshuar në këto vite mbeten të vlefshme deri në periudhën e realizimit të VPM (vlerësimit profesional të mësimdhënësve) ashtu që hyrja në fuqi e Kontratës së Arsimit nga data 18 prill 2017 deri me datën 22 janar 2021 ka qenë në fuqi dhe të njëjtës i takon e drejta për një kompensim të tillë.

Bazuar në listat e pagave të administruara gjatë shqyrtimit vërtetohet se paditësja ka realizuar pagën bazë 421.00 euro për periudhën për të cilën kërkohet kompensimi e që duke llogaritur me 27% del të jetë shuma prej 113.67 euro, nga duhet zbritur shtesën 58.35 euro që ka realizuar, dhe ka mbetur pa u realizuar shuma prej 55.35 euro për 30 muaj, pra $55.35 \times 30 = 1,660.50$ euro. Neni 55 paragrafi 1 i Ligjit të Punës parasheh se i punësuar ka të drejtën në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit çka rezulton se e paditura nuk i është përmbajtur Kontratës së punës dhe akteve administrative të cilat janë të zbatueshme që rezulton me pagesën e detyrimit paditëses.

Gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh nenin 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, me të cilin parashihet se: “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Sipas neneve të lartë cituara të Kontratë Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë detyrimi i punëdhënësit në rastin konkret i të paditurës për kompensim nga marrëdhënia e punës nënshkruar nga Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e cila prodhon efekt juridik ndaj punëdhënëses të cilët kanë të punësuar punëtorët që të drejtat e tyre burojnë nga ajo kontratë, në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditëses dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kontrata.

Sipas nenit 8 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës(LMD) është paraparë se “ Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij. Dispozita e nenit 245 paragrafi 1 i LMD-së ka paraparë se :”Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtje e tij”, prej nga rezulton se debitori këtu e paditura është e detyruar që kreditorit, këtu paditëses të ia paguajë vlerën e kërkesëpadsisë së aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij Aktgjykimi. Gjykata në kuptim të nenit 261 të LPK-së, nuk ka vendosur lidhur me kompensimin e diferencës në pagë për periudhën nga data 18 prill 2017 e deri në aprovim të kërkesëpadsisë ngase i autorizuari i paditëses gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 04 gusht 2022 ka bërë tërheqjen e padsisë për këtë periudhë sepse e paditura është thirrur në parashkrim të kërkesës për periudhën në fjalë.

Lidhur me kamatën Gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të LMD-së , ku parashihet se: “Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor dhe kamatën. Paragrafi 2 i këtij neni parasheh se “Lartësia e kamatë vonesës është 8% në vit, për veç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”. Paditëses i takon edhe kamata e gjykuar sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë bazuar në nenin 449 dhe 452 paragrafi 1 të LPK-së dhe TA dhe atë për taksën gjyqësore për padi shumën 20.00 euro, për përpilim të padsisë shumën 104.00 euro për një seance gjyqësore të shtyrë shumën prej 67.60 euro (50% të tarifës

prej 135.20) dhe për pjesëmarrjen e të autorizuarit të paditësit në një seancë në shumë 135.00 euro, në shumë të tërësishme 326.60 euro.

Gjykata në procedure bëri vlerësimin e të gjitha provave të parashtruara nga palët ndergjyqese, kurse në arsyetimin e Aktgjykimit iu referua vetëm provave që kishin ndikim vendimtar si dhe aplikimin e të drejtës materiale në marrjen e vendimit si më lartë.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr. 978/21, datë 30 gusht 2022

G j y q t a r j a
Afijete Sada Gllgjani

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së tij Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.